				dhe ruajtjen e vlerave të trashëgimisë kulturore. Për rrjedhojë, respektimi i kërkesave mjedisore dhe i procedurave të parashikuara nga legjislacioni përtrashëgiminë kulturore përbën një kusht thelbësor për zbatimin e projektit. Statusi i investitorit strategjiknuk përjashton në asnjë rast detyrimin për t'u pajisur me të gjitha aktet administrative, lejet dhea utorizimet përkatëse të kërkuara nga autoritetet kompetente, por përkundrazi e kushtëzon realizimin einvestimit me respektimin rigoroz të këtyre kërkesave. Megjithatë, duke vlerësuar interesimin tuaj dhe me synim garantimin e transparencës maksimale brendakufi jve të lejuar nga ligji, ju bëjmë me dije se në çdo rast, ne jemi të gatshëm për t'ju krijuar mundësinë ekonsultimit të dosjeve në ambientet e AIDA-s. Mundësia për t'u konsultuar me dokumentacionin, është një formë e aksesit në dokumentet zyrtare, që parashikohet dhe në nenin 6 të Konventës së Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare", ratifikuar me ligjin nr. 45/2022 "Për Ratifi kimin e Konventëssë Këshillit të Evropës "Për aksesin në dokumente zyrtare".		

19.	25.06.2026	Duke ju uruar nje dite te mbare, ju drejtohem me kerkesen per informacion, sipas shkreses bashkangjitur.	06.07.2026	Në vijim të kërkesës suaj, ju informojmë, se pyetjet tuaja ezaurohen plotësisht nga informaconi i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare të AIDA, respektivisht në link: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/ Këtu mund të gjeni të gjitha vendimmarrjet e Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), përfshirë dhe kërkesat e mos-pranuara për miratim statusi. Referuar nenit 18 të ligj 55/2015, i ndryshuar i cili parashikon përmbajtjen e një vendimi të KIS, në vendimet e publikuara, do të gjeni gjithçka të nevojshme për analizën tuaj.	E plotë	Nuk ka
20.	01.07.2026	Nisur nga denoncimet dhe shqetësimet që disa qytetare të fshatit Manastir kanëshprehur duke ngritur dyshime se do ndërtohet një resort turistik në	13.07.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, lidhur me projektet e zhvillimit dhe statusin e zonës së fshatit [redacted] Ju bëjmë me dije se pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit tëInvestimeve (AIDA) ka shprehur interes subjekti [redacted] i		

		fshatin e tyre,kërkojmë të dimë… 1. A ka nje projekt, projekt ide, apo leje që është lëshuar për në zonën e [redacted] Ju lutem na jepni informacion të detajuar për këtë 2. Së dyti sa banesa janë në këtfshat, sa të pa legalizuara, dhe sa janë me certifikata pronësie? 3. Banorët pretendojnë se ata banesa dhe biznese që nuk u jepen certifikatat lihen qëllimisht për ti hapur rrugë ndërtimeve? Keni		cili synon të realizojë një resort turistik nëkëtë zo ne. Projekti është në proces dhe klasifi kohet si ende i pa maturuar per vendimmarrje ngaKomiteti i Investimeve Strategjike (KIS). Për sa i përket pyetjeve tuaja mbi numrin e banesave, ecurinë e proceseve të legalizimit, lëshimin ecertifi kateve të pronësisë apo pretendimet e banorëve për këtë proces, Ju sqarojmë se AIDA nuk është institucioni përgjegjës për administrimin e këtij informacioni, ndaj për këto çështje mund t'i drejtohenizyrtarisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK). Po ashtu, lidhur me planin aktual të zhvillimit për gjirin e Manastirit dhe pjesën e sipërme të fshatit, për t'u njohur me dokumentet dhe planet vendore të miratuara, mund t'i drejtoheni zyrtarisht AgjencisëKombëtare të Planifi kimit të Territorit (AKPT) ose autoriteteve përgjegjëse të qeverisjes vendore.	E plotë	Nuk ka

		një koment për këtë? 4. A ka pasur konsultime me banorët? 5. Cfarë plan zhvillimi ka aktualisht zona gjiri i manastirit dhe pjesa e sipërme e fshatit? 6. A kanë shprehur vullnet investitorë për të investuar në këtë zonë. Nëse po sa kërkesa janë bërë? Cfarë projektesh strategjike kanë parashtruar këta investitorë?				
21.	02.07.2026	Kërkese për informacion dhe vënie në dispozicion të dokumentacionit zyrtar	14.07.2026	AIDA me shkresë zyrtare datë 14.07.2026 ka kthyer përgjige duke ezauruar të gjitha pyetjet.	E plotë	Nuk ka
22.	16.07.2026	Ju kërkoj të më vini në dispozicion	20.07.2026	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, lidhur me një projekt turistik në zonën e [redacted], ju bëjmë me dije se	E plotë	Nuk ka

		informacionin e mëposhtëm: 1. Nëse shoqërisë [redacted] është dhënë statusi "Investitor Strategjik" për projektin në fshatin [redacted] (2. Nëse po, ju lutem të më dërgoni: · Kopje të plotë të vendimit të Komitetit të Investimeve Strategjike. · Dokumentacionin e plotë të paraqitur [redacted]. për këtë projekt. · Verifikimet që AIDA ka kryer për të konfirmuar që pasuria nuk është		pranë Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) ka pasur 37nterest ë shprehur për zhvillimin e kësaj zone nga shoqëria [redacted], por ju sqarojmë se deri në këtë moment nuk ka asnjë vendimmarrje nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), për ta pajisur këtë subjekt me statusin investim/investitor strategjik.		

		objekt kthimi ose kompensimipronës or, sipas Ligjit Nr. 8/2025. 3. Nëse statusi nuk është dhënë, ju lutem të më konfirmoni me shkrim mungesën e tij. II. KËRKESË PËR LLOGARI Nga dokumentacioni në zotërim tim, rezulton se: · Prona është në pronësi të trashëgimtarëve, e vërtetuar me Vendimin Gjyqësor Nr. 75/2002. · Kjo pronë nuk është shitur, nuk është dhënë me qira, nuk është shpronësuar dhe				

		nuk ështëtransferuar. · Prona është objekt kthimi (dosja Nr. 208/2011 në ATP) dhe pjesë e një procesi gjyqësor (kallëzim nëSPAK). Nëse [redacted] ka marrë statusin "Investitor Strategjik", ju kërkoj llogari për sa më poshtë: 1. Si është verifikuar që kjo pronë nuk është objekt kthimi, sipas detyrimit të Ligjit Nr. 8/2025? 2. Pse nuk është marrë parasysh ekzistenca e një vendimi gjyqësor të formës së prerë				

		dhe e një dosjejenë ATP? 3. Cilat masa do të merrni për të rivendosur ligjshmërinë, nëse konfirmohet se statusi është dhënë nëkundërshtim me ligjin? Paralajmërim: Ky mosveprim dhe mungesa e transparencës do të dokumentohen dhe do të përdorennë procedurat para SPAK-ut dhe Avokatit të Popullit. Ju lutem të përgjigjeni brenda 10 (dhjetë) ditëvenga marrja e kësaj kërkese. Bashkëlidhur: Vendimi Gjyqësor Nr. 75/2002, Prokura dhe dokumentacioni mbështetës.				

23.	30.07.2026	Kërkoj kopje të dokumenteve të mëposhtme: Dosjen e plotë të aplikimit fillestar të paraqitur nga [redacted], duke përfshirë të gjitha bashkëlidhjet, dokumentet shoqëruese, ndryshimet, sqarimet, materialet plotësuese dhe çdo material tjetër të marrë deri më 30 dhjetor 2024. Dosjen e AIDA-s për vlerësimin paraprak dhe vlerësimin si investim strategjik të propozimit, duke përfshirë raportet e vlerësimit, vlerësimet e kritereve të pranueshmërisë ose kritereve të tjera,	03.08.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, lidhur me projektin e investimit [redacted], ju informojmë se ky projekt ka përfituar statusin strategjik me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) Nr[redacted] Sa i përket kërkesës suaj mbi vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit, ju sqarojmë se Ligji Nr. 55/2015, i ndryshuar, në Nenin 13, pika 1, germa dh), parashikon shprehimisht se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA "...autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë". Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, ku në Kreun I, pika 4, germa gj), parashikohet se dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme, "përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar". Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihen deklaratat zyrtare të subjektit aplikues "[redacted] ku	E plotë	Nuk ka

		memorandumet e stafit, rekomandimet dhe materialet e paraqitura Komitetit të Investimeve Strategjike. Të gjitha dokumentet e paraqitura nga [redacted] në zbatim të pikës 11 të [redacted], duke përfshirë planin e biznesit, studimin e fizibilitetit, analizatt eknike, ekonomike dhe tregtare, memorandumin shpjegues lidhur me pjesëmarrjen e shtetit, planin e zhvillimit të infrastrukturës, të drejtat e propozuara për shtetin, si dhe të gjitha bashkëlidhjet,		dokumentacioni është përcaktuar shprehimisht si konfidencial. Për sa i përket dokumenteve që lidhen procesin e negocimit, ju sqarojmë se pala shqiptare është ende në proces negocimi me palën investitore dhe marrëveshja nuk është finalizuar. Për më tepër, Komiteti Investimeve Strategjike (KIS) me vendim [redacted] të KIS duke shtyrë afatet e negocimit me subjektin përfitues të statusit strategjik. Në lidhje me vënien në dispozicion të Memorandumin e Mirëkuptimit, ju bëjmë me dije se ky akt është nënshkruar nga [redacted] është një akt që administrohet nga të gjitha palët që kanë nënshkruar atë. Megjithatë, duke vlerësuar interesimin tuaj dhe me synim garantimin e transparencës maksimale brenda kufijve të lejuar nga ligji, ju bëjmë me dije se në çdo rast, ne jemi të gatshëm për t'ju krijuar mundësinë e konsultimit të dosjeve në ambientet e AIDA-s. Për lehtësinë tuaj bashkëlidhur gjeni:		

		ndryshimet dhe versionet e rishikuara. Raportin mbi procesin e negocimit që Grupi i Negocimit të Marrëveshjes, ose GNM-ja, duhej të paraqiste sipas pikës [redacted] të Vendimit nr. 23, së bashku me projektaktet dhe materialete tjera thelbësore të paraqitura nga GNM-ja pranë AIDA-s ose Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike. Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ose të propozuar për nënshkrim ndërmjet [redacted]		1. Vendimi KIS Nr. 23, Datë 30/12/2024; 2. Vendimi KIS Nr. 11, Datë 30/12/2025; 3. VKM Nr. Nr. 515, datë 18.7.2003, i ndryshuar; 4. VKM Nr. 566, datë 8.10.2025; 5. Ekstraktin e regjistrimit të shoqërise [redacted]		

		[redacted], duke përfshirë çdo bashkëlidhje dhe versionin më të fundit të projektit që mbahet nga AIDA. Raportet, dokumentet e monitorimit ose përmbledhjet më të fundit që pasqyrojnë gjendjen ose ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të miratuar me [redacted]. ProPublica e publikon gazetarinë e saj pa pagesë për publikun. Këto dokumente i kërkoj për qëllime të mbledhjes së informacionit gazetaresk dhe				

		kërkimit, dhe jo për rishitje tregtare ose marketing. Ju lutem, më kontaktoni me telefon ose me email nëse AIDA ka pyetje lidhur me objektin e kësaj kërkese ose has vështirësi në identifikimin apo vënien në dispozicion të dokumenteve të kërkuara. Një bisedë mund të na ndihmojë të sqarojmë çështjet dhe të shmangim punë të panevojshme si për AIDA-n, ashtu edhe për mua si kërkues. Dëshiroj t'i marr kopjet në formë elektronike, mundësisht në format PDF ose në formate të tjera të				

		përdorura zakonisht dhe të lexueshme nga pajisjet kompjuterike. Dokumentet mund të më dërgohen me email ose të vihen në dispozicion nëpërmjet një shërbimi shkarkimi apo shkëmbimi skedarësh. Nëse ndonjë dokument që i përgjigjet kërkesës është tashmë i publikuar në internet, ju lutem të më dërgoni lidhjen e drejtpërdrejtë për atë dokument. Nëse AIDA refuzon dhënien e ndonjë dokumenti ose të një pjese të tij, ju lutem të më bëni të ditur dispozitën e posaçme ligjore mbi të cilën mbështetet				

		refuzimi, të vini në dispozicion të gjitha pjesët e pakufizuara që mund të ndahen në mënyrë të arsyeshme nga pjesët e kufizuara dhe të më informoni për procedurën dhe afatin përkatës të ankimit administrativ. Nëse AIDA konstaton se ndonjë dokument i kërkuar mbahet nga një autoritet tjetër publik, ju lutem të identifikoni atë autoritet dhe, kur lejohet, t'ia përcillni ose transferoni pjesën përkatëse të kësaj kërkese.				
24.	30.07.2026	Për ta ndihmuar AIDA-n në	03.08.2026	Sa i përket kërkesës suaj mbi vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit, ju	E plotë	Nuk ka

		identifikimin e dokumenteve që i përgjigjen kësaj kërkese, Komiteti i Investimeve Strategjike i dha projektit statusin "Investim Strategjik / Investitor Strategjik – Procedurë e Veçantë" dhe miratoi planin shoqërues të veprimit me [redacted] Vendimi gjendet në këtë adresë: Kërkoj kopje të dokumenteve të mëposhtme: 1.Dosjen e plotë të aplikimit fillestar të paraqitur nga [redacted] duke përfshirë të gjitha		sqarojmë se Ligji Nr. 55/2015, i ndryshuar, në Nenin 13, pika 1, germa dh), parashikon shprehimisht se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA "...autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilatnuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë". Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, ku në Kreun I, pika 4, germa gj), parashikohet se dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme, "përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara, shprehimisht, nga subjekti i interesuar". Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihen deklaratat zyrtare të subjektit [redacted]", ku dokumentacioni është përcaktuar shprehimisht si konfidencial. Për sa i përket dokumenteve që lidhen procesin e negocimit, ju sqarojmë se pala shqiptare është ende në proces negocimi me palën investitore dhe marrëveshja nuk është finalizuar. Për më tepër, Komiteti Investimeve Strategjike (KIS) me vendim [redacted]		

		bashkëlidhjet, dokumentet shoqëruese, ndryshimet, sqarimet, materialet plotësuese dhe çdo material tjetër të marrë deri më 30 dhjetor 2024. 2. Dosjen e AIDA-s për vlerësimin paraprak dhe vlerësimin si investim strategjik të propozimit, duke përfshirë raportet e vlerësimit, vlerësimet e kritereve të pranueshmërisë ose kritereve të tjera, memorandumet e stafit, rekomandimet dhe materialet e paraqitura Komitetit të Investimeve Strategjike.		[redacted] të KIS duke shtyrë afatet e negocimit me subjektin përfitues të statusit strategjik. Në lidhje me vënien në dispozicion të Memorandumin e Mirëkuptimit, ju bëjmë me dije se ky akt është nënshkruar nga [redacted], është një akt që administrohet nga të gjitha palët që kanë nënshkruar atë. Megjithatë, duke vlerësuar interesimin tuaj dhe me synim garantimin e transparencës maksimale brenda kufijve të lejuar nga ligji, ju bëjmë me dije se në çdo rast, ne jemi të gatshëm për t'ju krijuar mundësinë e konsultimit të dosjeve në ambientet e AIDA-s.		

		3.Tëgjitha dokumentet e paraqitura nga [redacted] në zbatim të pikës 11 të Vendimit nr. 23, duke përfshirë planin e biznesit, studimin e fizibilitetit, analizat teknike, ekonomike dhe tregtare, memorandumin shpjegues lidhur me pjesëmarrjen e shtetit, planin e zhvillimit të infrastrukturës, të drejtat e propozuara për shtetin, si dhe të gjitha bashkëlidhjet, ndryshimet dhe versionet e rishikuar. 4. Raportin mbi procesin e negocimit që Grupi				

		i Negocimit të Marrëveshjes, ose GNM-ja, duhej të paraqiste sipas pikës [redacted] të Vendimit nr. 23, së bashku me projektaktet dhe materialet e tjera thelbësore të paraqitura nga GNM-ja pranë AIDA-s ose Sekretariatit Teknik të Komitetit të Investimeve Strategjike. 5.Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ose të propozuar për nënshkrim ndërmjet [redacted] duke				

		përfshirë çdo bashkëlidhje dhe versionin më të fundit të projektit që mbahet nga AIDA. 6.Raportet, dokumentet e monitorimit ose përmbledhjet më të fundit që pasqyrojnë gjendjen ose ecurinë e zbatimit të Planit të Veprimit të miratuar me [redacted].				
25.	28.08.2026	1. Kopje të aplikimit të plotë të paraqitur nga [redacted] për përfitimin e statusit "Investim/Investitor Strategjik – Procedurë e Veçantë", së bashku me dokumentacionin shoqërues të	03.09.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion lidhur me projektin e investimit [redacted] ju informojmë se ky projekt ka përfituar statusin strategjik me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS) [redacted]. Sa i përket kërkesës suaj mbi vënien në dispozicion të dokumentacionit të projektit, ju sqarojmë se Ligji Nr. 55/2015, i ndryshuar, në Nenin 13, pika 1, germa dh), parashikon shprehimisht se subjekti aplikues, përveç të tjerash, dorëzon tek AIDA "...autorizimin mbi dakordësinë e investitorit për publikimin e detajeve të investimit të propozuar, përveç të	E plotë	Nuk ka

		administruar nga AIDA. 2. Kopje të Vendimit [redacted], të Komitetit të Investimeve Strategjike, së bashku me të gjitha anekset, shtojcat, hartat dhe planin e veprimit bashkëlidhur tij, si dhe çdo ndryshim të mëvonshëm të këtij vendimi. 3.Kopje të raportit të vlerësimit të projektit të përgatitur nga AIDA, përfshirë vlerësimin ekonomik, financiar, teknik dhe juridik mbi bazën e të cilit projekti iu propozua Komitetit të Investimeve		dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë". Kjo dispozitë e veçantë zbërthehet më gjerë në VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015, ku në Kreun I, pika 4, germa gj), parashikohet se dokumentacioni që dorëzohet duhet të përfshijë detyrimisht pranimin e shprehur të investitorit për publikimin e detajeve të përgjithshme, "përveç të dhënave që konsiderohen prej tij si konfidenciale, të cilat nuk mund të bëhen publike apo t'u shfaqen personave të tretë, të përcaktuara shprehimisht nga subjekti i interesuar". Për sa më lart, në dosjen e administruar përfshihen deklaratat zyrtare të subjektit aplikues [redacted] ku dokumentacioni është përcaktuar shprehimisht si konfidencial. Lidhur me vlerësimet e kryera nga Sekretariati Teknik dhe Grupi Operacional, ju bëjmë me dije se ato janë dokumente përgatitore, të cilat shërbejnë ekskluzivisht për marrjen e vendimmarrjes nga Komiteti I Investimeve Strategjike (KIS), si organi i vetëm vendimmarrës i ngarkuar nga ligji. Për rrjedhojë, i gjithë procesi i vlerësimit të kritereve dhe analizës së elementit strategjik pasqyrohet dhe përmblidhet në Vendimin e KIS, i cili është dokumenti zyrtar që konfirmon përputhshmërinë e projekteve me kërkesat e legjislacionit të sipërcituar. AIDA, në cilësinë e Sekretariatit Teknik, administron procedurën por nuk disponon		

		Strategjike për miratim. 4.Dokumentacionin dhe analizën mbi bazën e së cilës është parashikuar krijimi i rreth [redacted] vendeve të punës, përfshirë numrin e vendeve direkte dhe indirekte, nëse është bërë një ndarje e tillë, si dhe afatet e parashikuara për krijimin e tyre. 5. Listën e institucioneve publike të konsultuara gjatë shqyrtimit të projektit, së bashku me kopje të mendimeve, vlerësimeve dhe qëndrimeve të përcjella prej tyre pranë AIDA-s dhe/ose Grupit Operacional.		autorizimin për të shpërndarë dokumentacionin e brendshëm vlerësues apo të dhënat konfidenciale, jashtë parashikimeve të ligjit të posaçëm. Vendimet e KIS janë të zbardhura dhe të firmosura nga anëtarët e KIS, së bashku me planet e miratuara të veprimit për këto projekte. Vendimet në fjalë trajtojnë në mënyrë të qartë procedurën e ndjekur dhe dispozitat ligjore në fuqi në të cilat është bazuar ajo. Për lehtësinë tuaj, po ju përcjellim bashkëlidhur VKIS-n me anekset përkatëse. Ndërkohë, referuar vendimit të KIS, projekti i investimit shtrihet në një sipërfaqe totale prej afërsisht [redacted] ha janë në pronësi të pretenduar "shtet". Me Vendim të Këshillit të Ministrave [redacted] u realizua transferimi i pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat kadastrale [redacted], në Fondin e Pasurive tëPaluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (i cili administrohet nga ministria përgjegjëse përekonominë), për zhvillimin dhe realizimin e projektit të investimit [redacted] Përlehtësinë tuaj, po ju përcjellim bashkëlidhur VKM-në përkatëse. Lidhur me kërkesat tuaja mbi identifi kimin e pronave private apo për ato për të cilat nuk rezultoninformacion kadastral, ju lutemi të konsultoni me vëmendje Vendimin e KIS, përkatësisht pikat 8 dhe 9 tëtij.		

		6.Dokumentacionin e administruar gjatë procesit të verifikimit dhe konsolidimit të tokës së parashikuar për projektin prej rreth [redacted] hektarësh, përfshirë hartat, listën e pasurive dhe ndarjen sipas statusit të pronësisë. 7. Lidhur me rreth [redacted] hektarët e identifikuar si pronë private, kërkojmë dokumentacionin e paraqitur nga investitori mbi mënyrën e sigurimit të këtyre pronave për realizimin e projektit, përfshirë marrëveshje me pronarët, kontrata, deklarata pëlqimi apo dokumente të		Gjithashtu, vendimi i KIS parashikon se projekti i investimit do të zhvillohet si një zonë e vetme eintegruar, ku e gjithë sipërfaqja shpallet Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA), nëpërputhje me Ligjin Nr. 9789, datë 19.7.2007 "Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave të Teknologjisëdhe Zhvillimit Ekonomik", i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për ekonominë, në zbatim të Ligjit Nr. 9789, datë 19.7.2007 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar ngasubjekti, i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e Zonës (TEDA) dhe Zhvilluesit të saj, subjektin [redacted]. Aktualisht, me [redacted], u realizuashpallja e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik [redacted] dhe e zhvilluesittë saj me vendndodhje në Vlorë. Për lehtësinë tuaj, po ju përcjellim bashkëlidhur edhe këtë VKM. Së fundmi, sa i përket kërkesës suaj për raporte monitorimi, verifi kime në terren etj., ju sqarojmë semeqenëse statusi i investitorit strategjik për këtë projekt është miratuar gjatë këtij viti dhe shpallja ezonës TEDA e zhvilluesit të saj është bërë vetëm së fundmi, projekti ndodhet ende në fazën fi llestareadministrative e përgatitore. Për këtë arsye, punimet në terren nuk kanë filluar ende.		

		tjera të administruara nga AIDA. 8.Lidhur me rreth 6.3 hektarë për të cilët në dokumentacionin fillestar të projektit nuk rezultonte informacion kadastral, kërkojmë informacion mbi statusin aktual të tyre dhe dokumentacionin e administruar për identifikimin dhe verifikimin e pronësisë. 9.Dokumentacionin mbi bazën e të cilit është vlerësuar dhe miratuar dhënia e statusit "Procedurë e Veçantë" për projektin, si dhe dokumentacionin e administruar nga AIDA lidhur me				

		shpalljen e mëvonshme të [redacted] si zhvillues i zonës me procedurë jokonkurruese. 10.Kopje të raporteve të monitorimit, verifikimeve në terren, korrespondencës me investitorin dhe institucioneve përgjegjëse, të realizuara nga AIDA pas miratimit të statusit strategjik, si dhe informacion mbi nivelin aktual të realizimit fizik dhe financiar të projektit.				
26	29.09.2026	Në kuadër të studimit "Kushtet e punës, pagat e jetesës dhe ndikimi i krizës klimatike dhe ekologjike tek punëtorët në	10.07.2026	Subjektit iu kthye përgjigje duke iu përcjellë informacioni i kërkuar.	E plotë	Nuk ka

		industrinë e veshjeve, tekstilit dhe lëkurës në Shqipëri", të realizuar nga Instituti për Kritikë dhe Emancipim Shoqëror (IKESH), ju drejtohemi me kërkesën për vënien në dispozicion të informacionit dhe të dhënave përkatëse.				
27	06.10.2026	Jam studente e arkitekturës në [redacted] dhe në kuadër të një pune universitare po mbledh materiale mbi projektet e reja të zhvillimit turistik dhe arkitekturor në Shqipëri. Një nga projektet që po dokumentoj është zhvillimi i propozuar turistik në [redacted]			E plotë	Nuk ka

		Sazanit: Për të kuptuar më mirë projektin dhe procesin e zhvillimit të tij, do të doja të konsultoja dokumentacionin zyrtar të disponueshëm. Nëse është e mundur, do t'ju isha mirënjohëse nëse mund të më dërgonit ose të më orientonit drejt dokumenteve përkatëse, veçanërisht: raportin paraprak ose të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, VNM (Preliminary or Full Environmental Impact Assessment, EIA), nëse është përgatitur;				

		vendimin ose deklaratën mjedisore (Environmental Decision / Environmental Declaration); materialet e konsultimit publik (Public Consultation Documentation), nëse ka pasur; lejen e zhvillimit (Development Permit), nëse është miratuar; lejen e ndërtimit (Construction Permit), nëse është miratuar; planin e situacionit (Site Plan), planvendosjen (Site Layout / General Layout Plan) ose dokumentacion				

		tjetër planifikues të projektit; vendimet përkatëse lidhur me statusin e investimit strategjik (Strategic Investment Status Decisions); dokumentacionin lidhur me ndryshimin e statusit ose përdorimit të territorit/pronës në Ishullin e Sazanit (Land Status / Land-Use Documentation), nëse është relevant për projektin; çdo opinion ose miratim lidhur me ndikimin në zonat e mbrojtura, biodiversitetin ose mjedisin detar (Protected Area / Biodiversity / Marine				

		Environment Opinions or Approvals); datat e miratimit ose hyrjes në fuqi të dokumenteve të mësipërme (Dates of Approval / Effective Dates). Nëse ndonjë prej këtyre materialeve është tashmë i publikuar online, do ta vlerësoja shumë nëse mund të më dërgonit linkun përkatës. Në rast se një pjesë e dokumentacionit administrohet nga një institucion tjetër, do t'ju isha mirënjohëse nëse mund të më orientonit se ku duhet të drejtohem. Materialet do të përdoren vetëm për qëllime akademike				

		dhe për dokumentimin sa më të saktë të projektit.				
28	22.10.2026	[redacted] dhe [redacted] në Shqipëri, po punon për realizimin e një cikël shkrimesh pwr zonat Teda ne Shqiperi. Lidhur me projektin [redacted] në mbështetje të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe duke iu referuar vendimit [redacted] të Komitetit të Investimeve Strategjike, kërkojmë informacion dhe dokumentacion	02.11.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion nr. 246 Prot., datë 22.10.2026, ju bëjmë me dije sa më poshtë: Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS), me vendimin nr. 1, datë 11.02.2026, miratoi statusin "Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë" për projektin [redacted] Në këtë kontekst, vlen të theksohet se statusi "Investim/Investitor strategjik, Procedurë e Veçantë" është miratuar për një periudhë 4 (katër) vjeçare dhe është i kushtëzuar nga përmbushja e detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të vendimit të KIS-it, si nga subjekti investues, ashtu edhe nga institucionet e tjera të ngarkuara. Ndër kushtet e përcaktuara shprehimisht për subjektin investues është edhe detyrimi që, pas përfundimit të procesit të konsolidimit dhe qartësimit të situatës juridike-kadastrale, të vërë në dispozicion të Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme private që preken nga investimi potencial, në bazë dhe për zbatim të VKM-së nr. 1032, datë 16.12.2015. Subjekti nuk ka sjellë ende dokumentacionin përkatës pranë AIDA.	E plotë	Nuk ka

		lidhur me marrëveshjet ndërmjet shoqërisë [redacted] dhe pronarëve të pasurive të paluajtshme private të përfshira në territorin e projektit. Sipas dokumentacionit të projektit të paraqitur për marrjen e statusit të investitorit strategjik, sipërfaqja e përgjithshme e investimit është rreth [redacted] hektarë janë identifikuar si prona private. Në pikën 8 të vendimit të sipërpërmendur, Komiteti i Investimeve		Ndërkohë, për sa i përket sipërfaqes dhe statusit të pasurive të projektitj, ju bëjmë dijes se me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 510, datë 30.06.2026, është miratuar fillimisht transferimi në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) i pasurive të paluajtshme shtetërore në zonat kadastrale 8604 dhe 2765, Bashkia Vlorë, me një sipërfaqe totale prej 885,557.6 m2, ndërsa më pas, me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 615, datë 30.07.2026, kjo sipërfaqe është shpallur zyrtarisht "Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik [redacted] është shpallur zhvilluese e saj. Mënyra e funksionimit të Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA), përfshirja apo trajtimi i mëtejshëm i sipërfaqeve dhe zhvillimi i territorit rregullohen sipas procedurave të përcaktuara në Ligjin Nr. 9789, datë 19.7.2007 “Për Krijimin dhe Funksionimin e Zonave të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik”, i ndryshuar. Për këtë arsye, për çështjet që lidhen me procedurat specifike të zonës TEDA, përfshirjen e pronave private apo administrimin ligjor të mëtejshëm të zonës ekonomike, kompetencën e plotë institucionale e ka Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), ndaj për informacion më të detajuar mbi këto çështje mund t'i drejtoheni këtij institucioni.		

		Strategjike përcakton detyrimin e shoqërisë [redacted] për t'i vënë në dispozicion Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët e pasurive të paluajtshme private që preken nga investimi. Në këtë kuadër, kërkojmë: 1. A ka dorëzuar shoqëria [redacted] pranë Sekretariatit Teknik dokumentacionin e përditësuar të marrëveshjeve me pronarët privatë, në zbatim të pikës 8 të vendimit [redacted]? Nëse po, kërkojmë datat e dorëzimit dhe				

		dokumentet përkatëse. 2. Sa marrëveshje janë paraqitur nga RAMS Albania, me sa pronarë janë lidhur dhe cila është sipërfaqja totale e pasurive të paluajtshme që mbulojnë? 3. Cila është natyra juridike e marrëveshjeve të paraqitura? Kërkojmë të specifikohet nëse bëhet fjalë për kontrata shitblerjeje, qiraje, marrëveshje paraprake, marrëveshje bashkëpunimi apo forma të tjera të fitimit të së drejtës së pronësisë ose përdorimit.				

		4. Kërkojmë kopje të marrëveshjeve dhe dokumentacionit shoqërues të dorëzuar nga [redacted] 5. A përmbajnë marrëveshjet e paraqitura detyrime financiare për [redacted] ndaj pronarëve privatë? Nëse po, kërkojmë informacion mbi vlerën totale të kompensimit ose pagesave të parashikuara, afatet dhe kushtet e përmbushjes së tyre, sipas dokumentacionit që disponon institucioni juaj. 6. A ka paraqitur [redacted]				

		[redacted] dokumentacion që provon kryerjen e pagesave ndaj pronarëve privatë? Nëse po, kërkojmë numrin e marrëveshjeve për të cilat janë dokumentuar pagesa, sipërfaqen përkatëse dhe vlerën totale të pagesave të dokumentuara. 7. Për sa pasuri private dhe për çfarë sipërfaqeje nuk rezultojnë të jenë paraqitur marrëveshje ndërmjet [redacted] dhe pronarëve përkatës? 8. A ka raportuar [redacted] pranë Sekretariatit Teknik raste kur				

		pronarët privatë kanë refuzuar lidhjen e marrëveshjeve ose kur negociatat nuk kanë përfunduar me marrëveshje? Nëse po, kërkojmë informacion mbi numrin e rasteve dhe sipërfaqen e pasurive të përfshira. 9. A ka kryer Sekretariati Teknik verifikime për përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në pikën 8 të vendimit të KIS? Kërkojmë kopje të raporteve, korrespondencës dhe dokumentacionit që pasqyron rezultatet e këtyre verifikimeve. 10. Duke qenë se vendimi i KIS parashikonte një				

		territor prej rreth [redacted] hektarësh, ndërsa me vendimin e Këshillit të Ministrave të datës [redacted] u shpall zonë TEDA një sipërfaqe prej [redacted] kërkojmë të na informoni nëse [redacted] pronë private vijojnë të jenë pjesë e projektit të investimit strategjik. Nëse jo, kërkojmë aktet dhe dokumentacionin që pasqyrojnë ndryshimin e territorit të projektit.				
29	26.10.2026	Mbi ankimin ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare.	28.10.2026	Sqarojmë se me marrjen e njoftimit tuaj, AIDA kreu verifikimet teknike në sistemin e postës elektronike zyrtare të adresave info@aida.gov.al dhe lorina.salaj@aida.gov.al, për periudhën e muajit Shtator. Nga kontrolli i kryer rezultoi se e-maili i pretenduar nga gazetarja nuk ka mbërritur në asnjërën prej këtyre dy adresave. Për këtë arsye, moskthimi i përgjigjes brenda	E plotë	Nuk ka

				afateve ligjore nuk ka ardhur si pasojë e mosveprimit administrativ, por për shkak të mosmarrjes së e-mailit në sistemet tona elektronike. Gjithsesi, me qëllim garantimin e transparencës, përmbushjen e detyrimeve ligjore sipas Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" dhe respektimin e punës së gazetares, po ju sqarojmë si më poshtë vijon: Lidhur me pyetjet e ngritura për investimet ose projektet [redacted] gjatë periudhës 2013–2026, ju bëjmë me dije se pranë AIDA-s nuk është paraqitur asnjë shprehje interesi apo aplikim për përfitimin e statusit investim/investitor strategjik, nga kompani me [redacted] përgjatë kësaj periudhe. Për këtë arsye, institucioni ynë nuk disponon dokumentacion apo korrespondencë lidhur me këtë fakt. Gjithashtu, për çdo informacion tjetër mbi vendimmarrjet e Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS), orientojmë gazetaren të vizitojë faqen zyrtare të internetit të AIDA-s, në link: https://aida.gov.al/investimet-ne-shqiperi/strategjike/komiteti-investimeve-strategjike-kis/		

				Këtu mund të gjeni të gjitha vendimet e KIS, përfshirë dhe kërkesat e mos-pranuara për miratim statusi investim/investitor strategjik.		